UDHËZIM
Nr. 1, datë 26.2.2021

PËR NJË SHTESË DHE NJË NDRYSHIM NË UDHËZIMIN NR. 4038, DATË 4.9.2015 "PËR PËRCAKTIMIN E SHËRBIMEVE UNIVERSALE POSTARE QË OFROHEN PA PAGESË PËR PERSONAT E VERBËR DHE PJESËRISHT TË VERBËR"

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës dhe të pikës 4 të nenit 28, të ligjit nr. 46/2015 "Për shërbimet postare në Republikën e Shqipërisë",

UDHËZOJ:

Në udhëzimin nr. 4038, datë 4.9.2015 "Për përcaktimin e shërbimeve universale postare që ofrohen pa pagesë për personat e verbër dhe pjesërisht të verbër", bëhet një shtesë dhe një ndryshim si më poshtë:

1. Kudo në përmbajtje, emërtimi: Shoqata/ën e të Verbërve në Shqipëri" të zëvendësohet me fjalët "...Shoqatat apo organizatat e regjistruara për të verbrit në Shqipëri...".

2. Pas pikës 9, të shtohet pika 9/1, me këtë përmbajte:

"9/1. Përfaqësuesi i shoqatës apo organizatës për të verbrit, përfituese e shërbimeve universale postare pa pagesë sipas këtij udhëzimi, paraqet në sportelin postar kopje të dokumentit të regjistrimit në gjykatë."

3. Ngarkohet ofruesi i shërbimit universal postar dhe AKEP-i për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË
Belinda Balluku